



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 45, paragrafi 45.2 i Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, dhe të nenit 4, pika 4.3 e Rregullores për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunën e Prishtinës, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa të Kryeqytetit,

th ë r r e t

mbledhjen e shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më 15.09.2022 dhe do të fillojë në orën 10:00.

Mbledhja do të mbahet në sallën nr. 37 (kati II) të Kuvendit të Kryeqytetit.

Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Raporti i punës së Kryetarit të Komunës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022;
3. Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2023 dhe kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2023-2025;
4. Informatë për raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe plani i zbatueshmërisë për të gjeturat e këtij raporti;
5. Raportimi i Kryetarit të Kryeqytetit për kontratat e shfrytëzimit të pronës komunale;
6. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, me pronën e paluajtshme në pronësi të: Flora (Hasan) Çunajt, Arta (Nysret) Maliqit, Fatima (Hamit-Vej Nusret) Maliqit, Hana (Nysret) Maliqit, Arbëresha (Adem) Maliqit, Nevzat (Adem) Maliqit, Nexhat (Adem) Maliqit, Nakije (Nysret) Morinës, Nazan (Adem) Maliqit, Selamete (Hasan) Maliqit, Mevlyde (Hasan) Maliqit, Zana (Hasan) Sejdiut, Albulena (Hasan) Maliqit, Maliq (Abdul) Maliqit, Mihibe (Hasan) Makollit, Gëzim (Hasan) Maliqit dhe Luan (Nysret) Maliqit;
7. Projektregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës, nr. 01-030/01-0134831/18, dt. 06.06.2018;
8. Të ndryshme.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-060/01-205949, më 06.09.2022

KRYESUESI I KOMITETIT
Fehmi Kupria



Faqe 1 nga 1